

---

## OPINION I ISP

### MBI DRAFTIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E KUVENDIT (2026)

---

**Gjykata Kushtetuese** e Republikë së Shqipërisë në datën 10.02.2026 njëzëri, vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 57/2025 të datës 16.09.2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky vendim është një akt i rëndësishëm lidhur me legjislaturën aktuale, dhe e detyron Kuvendin të rishikojë praktikën dhe të kryejë ndërhyrje përmirësuese në përputhje me parimet dhe detyrimet kushtetuese.

Rregullorja e Kuvendit është një **akt i rëndësishëm** jo vetëm për deputetët dhe institucionin e Kuvendit, por edhe për jetësimin e parimeve të shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale në institucionin kryesor politik e përfaqësues në vend, Kuvendin e RSH.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) përgjatë viteve ka monitoruar, analizuar **dhe adresuar në Kuvend sugjerime përmirësuese lidhur me Rregulloren**, përfshirë edhe lidhur me elementët që u rrëzuan nga Gjykata Kushtetuese. Rishikimi i Rregullores është një detyrim institucional, por edhe nevojë, si dhe në kontekstin aktual edhe një sfidë për një parlament i cili duhet të ketë rol qendror në ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Për ISP pritshmëria dhe sugjerimi ishte që rishikimi i Rregullores të përfshijë në paketë edhe rishikime e plotësime të kuadrit rregullator të Kuvendit, përfshirë **Kodin e Sjelljes**, si dhe harmonizim të akteve me ligje në fuqi ose në proces, siç janë ato për **rolin e Kuvendit në procesin e integritetit, legjislacioni mbi lobimin, mbi konsultimin publik, mbi konfliktin e interesit, mbi dekriminalizimin**, etj.

*Kodi dhe Rregullorja e Kuvendit:* <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2024/01/ISP-Raport-studimor-Kodi-dhe-Rregullorja-Kuvend.pdf>

*Kodi i Sjelljes dhe praktikat e integritetit* <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2023/10/Broshure-informative-Kodi-i-Sjelljes-praktikat-modelet-dhe-standardet-e-integritetit-parlamentar.pdf>

Fatkeqësisht këto **sugjerime e pritshmëri nuk janë konsideruar** dhe drafti i ri me ndryshime bazohet vetëm në **nevojat ditore** të aktivitetit parlamentar, **pa një vizion e strategji afatgjatë për një parlament më të hapur, më funksional, më të besueshëm dhe më efektiv**. Praktikrat e gabuara të së kaluarës, kur dispozita evazive dhe procedura të njëanshme janë keqpërdorur për të legjitimuar akte politike në dëm të funksioneve kushtetuese të Kuvendit dhe rolit të tij në sistemin qeverisës, mund të përsëriten. Ndryshimet e reja nuk garantojnë standard të ri të modelit të BE.

Nga analiza e draftit të ndryshimeve të iniciuara në Rregulloren e Kuvendit ekspertët e ISP paraqesin opinionin e mëposhtëm, i cili i është adresuar në rrugë zyrtare edhe Kuvendit.

## I. Nisma për ndryshime në Rregullore

- Në traditën parlamentare në Shqipëri përgjithësisht ndryshimet në Rregullore kanë qenë pjesë e vendimmarrjes në nivelet e larta drejtuese të grupeve dhe produkt i konsensusit politik ose i përvojës së gjatë parlamentare, analizës dhe vlerësimit afatgjatë. Në rastin aktual kjo praktikë nuk është respektuar.
- Ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit janë iniciuar nga tre deputetë (Taulant Balla, Erion Malaj dhe Erjo Mile). Nga të dhënat e Kuvendit asnjëri prej tyre nuk është pjesë e Komisionit të Ligjeve në Kuvend (komision përgjegjës për rregullimet ligjore), si dhe vetëm zoti Balla është pjesë e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, strukturë përgjegjëse për rregulloren. Fakti se shumica e iniciuesve të ndryshimeve nuk janë pjesë e strukturës përgjegjëse dhe as ekspertë me përvojë në çështjet parlamentare (janë betuar deputetë për herë të parë në shtator 2025) është tregues se nisma është më shumë politike sesa produkt i një analize dhe vlerësimi profesional dhe strukturor në parlament.

## II. Konfirmim i strukturës së re të komisioneve

- Ndryshimet në rregullore konfirmojnë vendimin e Kuvendit në shtator 2025 për strukturën e re të komisioneve, emërtimin dhe fushëveprimin e tyre.

## III. Procedura e përshpejtuar e akteve lidhur me integrimin

- Përcaktimi në Rregullore i procedurës së përshpejtuar reflekton ndryshimet me ligjin 77/2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimin të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”. Megjithatë Rregullorja **duhet të reflektoje parimin se kjo procedurë nuk cenon detyrimet ligjore në fuqi për transparencë dhe konsultim publik**. Ky element mungon.
- Ndryshimet në Rregullore nuk kanë ofruar asnjë element të ri për të forcuar procesin e **konsultimit dhe përfshirjes publike në procesin ligjvënës**, si dhe për të rritur transparencën e punës së Kuvendit, përfshirë Komisioneve të përhershme dhe të posaçme. Kjo, për më tepër, kur ligji 77/2025, neni 20, ngarkon Kuvendin të përcaktojë rregullat e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për angazhimin dhe informimin e tyre lidhur me angazhimet në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian duke garantuar transparencën e veprimtarisë së tij për çështjet e negociatave dhe anëtarësimit dhe gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në këtë proces.

## IV. Kufizimi i kohës së diskutimeve

- Propozimi për uljen e kohës së diskutimit për ministrat dhe deputetët nga 10 në 5 minuta është pozitiv dhe në përputhje me praktikën e shumë parlamenteve brenda BE-së.

## V. Procesi i Kontrollit Post-Legjislativ

- Rregullorja në fuqi ia ngarkonte çdo komisioni përgjegjës për Kontrollin Post-Legjislativ, shoqëruar me seanca dëgjimore publike. Kjo e drejtë parimisht konfirmohet, por ndryshimet në rregullore i japin rol thelbësor “Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen

*institucionale*”, i drejtuar nga PS. Ky komision “*koordinon dhe ndjek realizimin e procesit të Kontrollit Post-Legjislativ të ligjeve*” duke bashkëpunuar edhe me komisionet e tjera të përhershme parlamentare brenda fushave përkatëse të tyre të përgjegjësive”, pra krijon hierarki midis komisioneve, duke i dhënë prioritet mbi komisionet e tjera.

## VI. Raportimi i institucioneve të pavarura / kushtetuese

Praktika e raportimit të institucioneve të pavarura ka pësuar disa ndryshime të rëndësishme.

- **Afati Ligjor.** Pozitive është përfshirja e detyrimit që, në rastet kur afati ligjor për depozitimin e raportit nuk është i përcaktuar në ligjin organik të institucionit, Konferenca vendos afatin e depozitimit të tij.
- **Projektrezoluta.** Me ndryshimet e reja Komisioni përgjegjës i fushës organizon seancë dëgjimore dhe në përfundim të diskutimeve harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, ose përfshin rekomandime specifike në raportin e komisionit të cilat ja përcjell komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale. Shtesa e fundit, për rekomandime specifike jashtë rezolutës, të cilat i adresohen një komisioni tjetër të veçantë, e vendos këtë të fundit në pozita dominuese mbi komisionet e tjera parlamentare.
- **Seanca dëgjimore.** Me Rregulloren e re nuk janë komisionet përgjegjëse të fushës që organizojnë seancën dëgjimore në të cilën drejtuesi i institucionit raporton për zbatimin e rezolutës së Kuvendit për vitin paraardhës dhe vlerësimin rreth projektrezolutës/rekomandimeve të paraqitura nga komisioni përgjegjës i fushës për vitin në vazhdim. Kjo e drejtë i kalon Komisioni për mbikëqyrjen institucionale. Me këtë kompetencë komisionet përgjegjëse të fushës **dobësohen** dhe forcohet Komisioni për mbikëqyrjen institucionale.
- **Rezoluta vs rekomandimet specifike.** Komisioni për mbikëqyrjen institucionale fiton edhe një kompetencë shtesë, - ai paraqet në seancë projektrezolutën për institucionet e pavarura, kurse sipas ndryshimeve të reja në Rregullore “*raporti me rekomandime specifike, i përcillet me shkresë institucionit të pavarur përkatës*”. Kjo do të thotë se ka një rezolutë për përcaktime përgjegjësish dhe ka një raport tjetër me rekomandime specifike që nuk kalon në seancë, ndryshe nga praktika e deritanishme.

## VII. Lidhur me shoqërinë civile

- Rregullorja në fuqi parashikonte të drejtën e shoqërisë civile për të adresuar mendimin me shkrim mbi raportet vjetore të institucioneve të pavarura. Me ndryshimet e reja ato mund të ftohen në një seancë dëgjimore, një zgjidhje që bëhet nga komisioni/Kuvendi dhe që nuk legjitimon adresimet me shkrim nga organizatat.

## VIII. Lidhur me raportimin e institucioneve në seancë plenare

- Rregullorja parashikonte të drejtën dhe detyrimin e titullarit të institucionit të paraqesë raport për jo më shumë se 20 minuta në seancë plenare. Me ndryshimet e reja ky mekanizëm është hequr, dhe thuhet se “*në seancë plenare lexohet projektrezoluta për vlerësimin e punës së institucionit dhe më pas vijohet me diskutimet në lidhje me të*”.

- **Thirrja e institucioneve të pavarura.** Nga praktika aktuale është hequr e drejta që një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë të thirren në seancë plenare drejtuesit e institucioneve shtetërore për të dhënë shpjegime ose për të informuar Kuvendin për çështje të veprimtarisë së tyre. Nga ana tjetër, është shtuar një kompetencë e re për Komisionin përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale, i cili *“kur çmohet e nevojshme informon Kuvendin për problematikat e dala”*. Përcaktimi **“kur çmohet e nevojshme”** lë hapësirë për preferenca dhe spekulime politike në vendimmarrje, standardi duhej të ishte i qartë dhe i njësuar.
- **Detyrimi për koordinim.** Dobësimi i rolit të komisioneve të përhershme vijon edhe në nenin 9 të propozimeve të reja në Rregullore, sipas të cilit, nismat e komisioneve për të thirrur institucionet e pavarura për informim duhet *“koordinuar paraprakisht me Komisionin për Çështjet Evropiane.”* Kjo i jep këtij komisioni veto ndaj kërkesave që mund të vijnë nga komisionet e tjera, sidomos ato që drejtohen nga opozita. E njëjta praktikë del edhe në përcaktimin kushtëzues se para miratimit kalendari koordinohet me Komisionin përgjegjës për Çështjet Evropiane.
- **Nëse e çmon të arsyeshme.** Neni 11 që lidhet me ndryshime në nenin 103/4 të Rregullores aktuale, përcakton se në mbyllje të çdo sesi Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale i paraqet Konferencës së Kryetarëve një raport informues mbi këtë proces. Kryetari i Kuvendit nëse e çmon të arsyeshme vendos paraqitjen e tij në seancë plenare." Përfshirja e termit **“nëse e çmon të arsyeshme”** e bën procesin evaziv, selektiv dhe politik.
- **Peticionet drejtuar Kuvendit.** Edhe ndryshimet në Rregullore lidhur me petitionet që i drejtohen Kuvendit, i japin gjithashtu Komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale një rol primar. Të gjitha petitionet kalojnë nga ky komision, dhe drafti i ri përcakton se *“në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit, për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit”*. Përfshirja e termit **“e gjykon të arsyeshme”** e bën procesin evaziv, selektiv dhe politik.

## IX. Lidhur me zgjedhjen e organeve kushtetuese ose të krijuara me ligj

- Rregullorja e re ndan procedurën midis rasteve që kërkojnë mbështetje nga 28 deputetë dhe praktikave të tjera, por në thelb, disa elementë të rinj marrin vëmendje.
- **Afati detyrues 30 ditor.** Në rregulloren aktuale përcaktohej detyrimi i Kuvendit “kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës dhe jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i mandatit ose nga data e shkarkimit”. Afati 30 ditor është hequr, duke e lënë të papërcaktuar fazën fundore të vendimmarrjes. Ndryshimet e reja përcaktojnë se “Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës”, proces që nuk kufizohet në kohë, siç ishte në Rregulloren aktuale.
- **Transparenca publike.** Përveç detyrimit që lista e kandidatëve të jetë publike **nuk është përfshirë** në Rregullore detyrimi që CV e kandidatëve dhe të dhëna të tjera (formulari i dekriminalizimit, etj) të jenë gjithashtu publike.